

L I G J
Nr.8180, datë 23.12.1996

PËR NJË NDRYSHIM NË KODIN E PROCEDURËS PENALE TË REPUBLIKËS TË SHQIPËRISË

Në mbështetje të neneve 16 dhe 43 të ligjit nr.7491, datë 29.4.1991 "Për Dispozitat Kryesore Kushtetuese", me propozimin e një grupi deputetësh,

KUVENDI POPULLOR
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

V E N D O S I:

Neni 1

Në ligjin nr.7895, datë 27.1.1995 "Për Kodin e Procedurës Penale", shtohet neni 432/a me këtë përmbajtje:

"Rekursi në interes të ligjit

Kundër vendimit të formës së prerë të gjykatës së shkallës së parë, Gjykatës së Apelit dhe të Kolegjit Penal të Gjykatës së Kasacionit, për shkaqet e parashikuara në nenin 432, Prokurori i Përgjithshëm mund të ushtrojë rekurs për prishjen e vendimit në interes të ligjit.

Rekursi kundër vendimit të Kolegjit Penal të Gjykatës së Kasacionit shqyrtohet nga kolegjet e bashkuara të kësaj gjykate.

Për kalimin në seancë gjyqësore të rekursit ndaj vendimeve të formës së prerë të Kolegjit Penal të Gjykatës së Kasacionit, duhet të vendoset në dhomën e këshillimit.

Anëtarët e kësaj gjykate që kanë dhënë vendimin ndaj të cilit bëhet rekurs, nuk kanë të drejtë të bëjnë pjesë në dhomën e këshillimit.

Për shqyrtimin e rekursit zbatohen rregullat e gjykimit në kolegji.

Rekursi në interes të ligjit ushtrohet brenda një viti nga dita që vendimi ka marrë formë të prerë."

Neni 2

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Shpallur me dekretin nr.1696, datë 30.12.1996 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Sali Berisha